

REPUBLIKA E KOSOVË
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive

Nr./Br./No. 5034
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 8
Data/Datum/Date: 15.12.2021
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA



REPUBLIKA E KOSOVË
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS/AGENCIJA ZA ŠUME KOSOVA/KOSOVO FOREST AGENCY
Arkivi - Arhiva - Archive

Nr./Br./No. 5069
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 8
Data/Datum/Date: 14.12.2021
Prishtinë /a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT


Agjencia Pyjore e Kosovës
Agencija za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency


LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	KE-778 / 2021			
PËR/ZA/TO:	Znj. Flutura MUSTAFA, Këshilltare e Ministrit			
PERMES/PREKO/THROUGH				
CC:	z. Faton PEÇI , Ministër në MBPZHR			
NGA/OD/FROM:	Bekim HOXHA, zv Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë Pyjore të Kosovës (APK)			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i Veprimit për parandalimin/zvogelimin e prerjeve ilegale në pyje			
Nr. i zyrës:	Lokacioni:	Prishtinë	Data:	14.12.2021
Br. kancelarije:	Kucni:		Datum:	
Room No.:	Extension:		Date:	

E nderuara znj. Mustafa,

Bashkëngjitur keni Planin e Veprimit për parandalimin/zvogelimin e prerjeve ilegale në pyje.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural -
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja -
Ministry Of Agriculture, Forestry and Rural Development

Ref. No: 938

13.12.2021

Plani i Veprimit për parandalimin / zvogëlimin e prerjeve ilegale në pyje

Prejjet ilegale në pyje janë problemi kryesor me të cilin është duke u ballafaquar sektori i pylltarisë. Parandalimi apo zvogëlimi i tyre është padyshim një nga sfidat kryesore të institucioneve të cilat merren me menaxhimin e pyjeve. Në këtë drejtim, nevojitet ndërmarrja e një numri të masave dhe veprimeve konkrete, të institucioneve të cilat janë të përfshira edhe në Task Forcën e MSHLP.

Plani i Veprimit përmban një numër masash, realizimi i të cilave varësisht nga natyra e veprimit shtrihet në periudha, më të shkurtra apo më të gjata kohore:

- Veprime të menjëhershme – afatshkurtra, (1-6 muaj);
- Veprime afatmesme, (6 deri në 12 muaj);
- Veprimet afatgjata, (më afatgjata se 12 muaj);

Gjithashtu në Plan të Veprimit do të përcaktohet afati kohor i përmblshjes së veprimit / masës konkrete, pastaj institucioni bartës, institucionet mbështetëse dhe ndikimi buxhetor / kostoja financiare e realizimit të masave / veprimeve të caktuara aty ku mund të kuantifikohet financiarisht.

Task Forca po ashtu, aprovon formën e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit / përmeshjes të këtij Plani të Veprimit, dhe i cili kontribuon në rifjen e nivelit të zbatimit të ligjshmërisë në sektorin e pylltarisë në Kosovë. (Ky dokument i monitorimit është përpiluar në formatin, që duhet plotësuar me të dhënat dhe informacionet nga institucionet përfaqësuese, dhe formati i tij do të diskutohet në takimin vijues të Task Forcës, që planifikohet të mbahet në muajin shkurt të vitit 2022).

Masat/ Veprimet:

Nr. rendor	Masat/Veprimet e propozuara	Afati i realizimit	Institucioni bartës	Institucionet mbështetëse	Kosto financiare
1	Vendimi i Qeverisë për krijimin e Task Forcës për Mbrojtjen dhe Shfrytëzimin Legal të Pyjeve është një hap shumë i rëndësishëm i cili bëhet për herë të parë në vendin tonë, pasi që përmes funksionimit të saj do të bëhet e mundur që të koordinohen veprimet e të gjitha institucioneve së bashku në luftimin e prerjeve ilegale në pyje. Mbatja e takimeve të rregullta periodike të Task Forcës dhe koordinimi ndërinstitucional i veprimeve në mbrojtjen e pyjeve;	Janar - Dhjetor	MBPZHR	MMPHI MFPT MTI Gjykatat Prokuroritë Policia	Kosto administrative
2	Funksionalizimi i Fondit për Ripërtëritjen e Pyjeve (sipas nenit 8 të Ligjit 2003/3 për Pyjet e Kosovës). Sipas ligjit ky është fond i dedikuar për qëllime të veçanta brenda buxhehit të MBPZHR-së, me qëllim që t'i mundësohet Ministrisë investimi dhe inkurajimi i të tjerëve të investojnë në pylltari dhe të mbështesë shërbimet ose projektet tjera të ndërlidhura me tokat pyjore;	Janar	MBPZHR		Kosto administrative
3	Funksionalizimi i Bordit Pyjor Këshillëdhënës (sipas nenit 9 dhe 10 të Ligjit 2003/3 për Pyjet e Kosovës). Ky Bord sipas ligjit, ka këto funksione: Të mbikëqyrë dhe shqyrtojë administrimin dhe menaxhimin e pyjeve në Kosovë, të këshillojë Agjencinë Pyjore të Kosovës. Dhe t'i japë udhëzime autoriteteve përkatëse dhe opinionit mbi përmirësimin e pyjeve në Kosovë;	Janar	MBPZHR		Kosto administrative
4	Aprovimi i Ligjit të ri për pylltarinë – Është hap shumë i rëndësishëm ligjor, pasi që përmes tij, ndër të tjera, do të bëhet e mundur që kompetencat në mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve të transferohen nga niveli komunal në atë qendror, përkatësisht në Agjencinë Pyjore të Kosovës;	Mars - Qershor	MBPZHR Qeveria Kuvendi		Kosto administrative

5	<p>Angazhimi i Drejtoratit Qendror të Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti, në veprimet për zbatimin e ligjshmërisë në sektorin e pylltarisë, dhe lufimit të prerjeve ilegale, përmes përgatitjes dhe zbatimit të Planit Dinamik Operacional. Bazuar në nevojat e DQIPGJ, por edhe në orientimet e Qeverisë për rritjen e numrit të inspektorëve, ekziston nevoja edhe për rritjen e numrit të inspektorëve edhe për 12 inspektorë. Për shkak të natyrës së punës së inspektorëve, si dhe ekzistimit të praktikave të tilla në institucionet tjera, dhe me qëllim të stimulimit të tyre në punë, duhet që të përfshihet edhe pagesa e rrezikshmërisë në punë;</p>	Janar - Dhjetor	DQIPGJ	APK/MBPZHR	<p>Kosto administrative, Shtimi i stafit të DQIPGJ për 12 inspektorë: 69 120 Euro / vit (pozicioni i pagave) Blerja e kompjuterëve dhe pajisjeve të punës për 12 inspektorë të rinjë = 6000 euro Nevojiten edhe 6 vetura me çmim prej 12 000 euro = 72 000 euro Shtesa e rrezikshmërisë në punë (minimumi 100 euro/muaj, për 24 inspektorë): 28 880 euro Totali = 176 000, 00 euro</p>
6	<p>Rritja e efikasitetit të Gjykatave dhe Prokurorive në trajtimin e fletëparaqitjeve ndaj prerësve ilegale, me theks të veçantë në politikën ndëshkimore, pasi që deri tash përveç parashkrimit të shumë lëndëve, vonesave dhe neglizhencës, edhe në rastet kur dënimet marrin formën e prerë, ato janë shumë të ulta, dhe për fat të keq, në vend të frikësimit, i stimulojnë keqbërësit në kryerjen e veprave të reja. Për qdo tremujor Task Forca do të shqyrtojë numrin e fletëparaqitjeve të dëguara në Gjykata, dhe numrin e Vendimeve nga Gjykatat, si dhe numrin e lëndëve të parashkruara;</p>	Janar-Dhjetor	Gjykatat Prokuroritë	APK/MBPZHR	Kosto administrative
7	<p>Veprimet në aspektin socio-ekonomik- Është e evidente se një numër i demeve bëhen edhe nga banorët lokalë në afërsi të pyjeve, si dhe ata me gjendje të rëndë ekonomike, të cilët drurin e përdorin për ngrohje, dhe atë e kanë si alternativë të vetme. Kjo kategori do të mund të trajtohet, duke kombinuar veprimet me karakter socio-ekonomik, përkatësisht pas identifikimit të saktë të tyre, dhe duke u ofruar atyre ndonjë program të mbështetjes (grante dhe subvencione) nga programet ekzistuese të MBPZHR-së. Kështu, ata fillimisht do të mund të furnizoheshin me dru për ngrohje sipas një skeme të caktuar të 'shitjes së lirë', dhe me çmime të volitshme, mirëpo, po ashtu edhe me grante të vogla në sektorë të ndryshëm si p.sh. në blegtori, bletari, eko-turizëm, grumbullimin e farërave të drunjtëve, etj, ku ata përmes këtyre veprimtarive do të vetë punësoheshin dhe do të</p>	Janar-Mars	MBPZHR/APK	AKPPPK	<p>Kosto administrative, si dhe koordinimi MBPZHR/APK, që kjo masë të përfshihet në Programin e Grantëve dhe Subvencioneve të MBPZHR-së për vitin 2021.</p>

	<p>krijonin të hyra shtesë. Gjithashtu duhet të promovohen forma tjera të bashkëpunimit me banorët pranë zonave të pyjeve, sikurse që janë format e menaxhimit të përbashkët të pyjeve etj. Në këtë mënyrë, do të arrihej që nga dëmtuesit aktualë të pyjeve, ata të shndërroheshin në partnerë në ruajtjen e pyjeve;</p>				
8	<p>Rritja e numrit të rojeve – Sipas bazës ligjore një roje pylli është i ngarkuar për ruajtjen e një sipërfaqe pylli prej 1500 hektarësh. Në shumë raste kjo sipërfaqe tejkalohet. Hapi i parë do të ishte që kjo normë të zbatohet plotësisht, dhe aty ku nuk ka roje të pylli të mjaftueshme, të pranohen të rinjtë menjëherë;</p>	Janar-Qershor	Komunat	MBPZHR MFPT	<p>Sipas të dhënave të fundit nga Njësitë Komunale, janë gjithsej 201 rajone/terrene pyjore. Janë gjithsej 171 roje pylli të punësuar me kontratë të rregullt. Që d.m.th për të mbuluar edhe 30 rajone tjera duhen punësuar edhe 30 roje pylli. Paga aktuale e rojës së pyllit është 270 € \ muaj x 30 roje = 8,100 € \ muaj\bruto Totali = 97 200 euro / vit P.S. Megjenëse aktualisht rojet e pyjeve janë punëtorë të komunave, këto janë shpenzime që duhet planifikuar në buxhetet komunale.</p>
9	<p>Rojet e pyllit nuk kanë vetura dhe mjete tjera për garkullim. Duhet bërë një zgjidhje e menjëhershme, pasi që është shumë vështirë që një sipërfaqe prej 1500 e më tepër hektarësh, të mbrohet e monitorohet pa mjete teknike, pasi që shumë roje pylli duhet që çdo ditë të udhëtojnë me kilometra të tëra deri në vendin e tyre të punës;</p>	Janar-Dhjetor	Komunat	APK/MBPZHR MFPT	<p>Duke pasur parasysh se rojaret duhet të kenë një shef të mbrojtjes mbikëqyrës, minimumi duhet një makinë për sektorin e mbrojtjes që d.m.th. gjithsej kemi 38 Njësi Komunale, atëherë nevojiten së paku nga një veturë për çdo Njësi Komunale: 23 vetura x 15 000, 00 euro = 345 000,00 € Totali = 345 000,00 euro P.S. Megjenëse aktualisht rojet e pyjeve janë punëtorë të komunave, këto janë shpenzime që duhet planifikuar në buxhetet komunale.</p>
10	<p>Pagat e ulëta të rojeve të pyjeve (aktualisht në nivelin 270 euro / muaj) në raport me kushet e vështira të punës dhe rreziqet, janë faktor demotivues në punën e tyre. Duke pasur parasysh që rojet e pyllit janë në vazhdimësi të rrezikuar dhe</p>	Janar-Mars	Komunat	APK/MBPZHR MFPT	<p>Atëherë për 201 roje = 20,100 € \ muaj. Përkatesisht 241 200 euro/vit. Totali = 241 000, 00 euro / vit</p>

	<p>për këtë arsye edhe janë të pajisur me armë zjarri, mendojmë që atyre duhet t'iu jepet edhe shtesa për rrezikshmëri në punë, edhe atë në vlerë monetar, rreth 100 €\ roje \ muaj;</p>				
11	<p>Duhet që të rritet buxheti për institucionet që merren me menaxhimin e pyjeve, duke përfshirë Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe Njësitë Komunale të Pyltarisë;</p>	Janar- Mars	Komunat APK MBPZHR	MFPT	<p>Rritja e buxhetit të sektorit duhet të bëhet në koordinim me Ministrinë e Financave, dhe ne si MBPZHR /APK do të arsyetojmë nevojën për projektet e nevojshme.</p> <p>Donacion i projektit të financuar nga Suedia.</p>
12	<p>Furnizimi me mjete të nevojshme teknike për mbrojtjen e pyjeve – Këtu hyjnë mjetet sikurse që janë dronët, kamerat, dylbitë dhe pajisjet tjera për parandalimin dhe zvogëlimin e prejeve ilegale në pyje. Në këtë drejtim fillimisht do të kontribuoj edhe projekti “Mbështetje për forcimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumë-qëllimor të pyjeve për të përmirësuar jetesën në zona rurale dhe adresimin e ndryshimeve klimatike në Kosovë”, i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe Komisioni Evropian, dhe që po implementohet nga FAO. Në fazën e parë përmes projektit do të sigurohen këto pajisje: Drona 4 copë, kamera termale (kamera kurthe të pajisura me sistemin 3G/4G) 10 copë, pajisje GPS 12 copë dhe dylbi të natës 10 copë. Kurse në fazën e dytë do të sigurohen edhe 44 kamera termale, dylbi të natës 40 copë, pajisje për GPS 42 copë, makina terreni 4x4 Pickup të pajisura me kamera/GPS, kamion 3 copë dhe tabletë/PDA 7 copë.</p> <p>Krahas kësaj është e nevojshme edhe planifikimi i furnizimeve me mjete teknike të kësaj natyre me financim nga buxheti;</p>	Janar-Dhjetor	Komunat APK Donatorët	MBPZHR MFPT	<p>Nga buxheti planifikohet edhe furnizimi me këto pajisje: 285 kamera x 350 Euro= 100 000, euro Dronë: 10 x 2 500, 00 = 25 000, 00 Euro Dylbi te natës: 50 x 300,00=15 000,00 Kamera statike: 5 x 12 000, 00= 60 000,00 euro Totali nga buxheti= 200 000, 00 euro</p>
13	<p>Funksionalizimi i Sistemit Informatik të Pyjeve të Kosovës (SIPK), përmes të cilit do të krijohet lidhshmëria e garkullimit të informatave në mes të rojeve të pyllit, komunave, APK-së, por edhe institucioneve tjera të ndërlidhura me funksionet e menaxhimit të pyjeve;</p>	Janar-Mars	APK	MBPZHR MPBAP	<p>Donacion i projektit të financuar nga Suedia.</p>

14	Krijimi i Kadastrit Pyjor të Kosovës, përkatësisht Regjistrir Kombëtar të Pyjeve dhe Tokave Pyjore të Kosovës, si dhe rregullimi i gëshjes së titullarit të pronësisë në certifikatat e pronësisë për ngastrat e pyjeve dhe tokave pyjore;	Janar-Dhjetor	APK	MBPZHR MMPHI AKK	Për përcaktimin e vlerës financiare të kësaj mase duhet të mbahet një takim në mes të: Agjencisë Kadastrale të Kosovës, MMPHI, MBPZHR dhe APK-së. (Kjo masë është e karakterit afatgjatë)
15	Kontrollimi i garkullimit të masës drunore në rrugët magjistrale dhe nacionale, dhe verifikimi i dokumentacionit përcjellës (damkat pyjore dhe fletë përcjellëset për masën drunore në garkullim), nga policia dhe Inspektorati i Tregut të MTT-së;	Janar-Dhjetor	Policia Inspektorati i tregut MTT	APK DQPGJ Komunat	Kosto administrative
16	Krijimi i disa postblloqeve statike të kontrollit nga policia, në rrugët dhe pikat strategjike, të daljes nga pyjet, dhe kyçjeve në rrugët magjistrale;	Janar-Dhjetor	Policia	APK Komunat	Konsiderojmë që për fazën e parë nevojitet vendosja e 10 postblloqeve, në pikat ku veprimet ilegale në pyje janë më të shprehura. P.S. Koston e funksionimit të një postblloku e kalkulon Drejtoria e Policisë.
17	Kyçja aktive e Administratës Tatimore të Kosovës në luftimin e informalitetit në pylltari, sidomos të operatorëve ekonomik të mëdhenj në sektorin e pylltarisë, të depove të shites së drunjëve, si dhe kontrolli i origjinës / prejardhjes së masës drunore të hedhur në shitje dhe garkullim;	Janar-Dhjetor	ATK	APK/MBPZHR MFPT	Kosto administrative
18	Cakimi i gjykatësve dhe prokurorëve që do të merren ekskluzivisht vetëm me trajtimin e lëndëve për dëmet në pyje, dhe trajtimin e fletëparaqitjeve për dëme në pyje;	Janar-Dhjetor	Gjykatat Prokuroritë	APK/MBPZHR Komunat	Kosto administrative
19	Krijimi i një Njësie / Departamenti të veçantë në kuadër të Policisë për luftimin e prerjeve ilegale në pyje dhe luftimit kundër krimeve mjedisore;	Janar-Mars	Policia	APK/MBPZHR	Kosto administrative
20	Zbatimi i politikës ndëshkimore konform dispozitave ligjore, (të hedhet poshtë praktika e gjyqeve, ku në vendimet për dënime ndaj prerësve ilegal të pyjeve, përveç dënimeve me vonesë të madhe, dhe shumë të ulta, zakonisht nga gjykatat përmendet justifikimi se kryerësi e veprave ilegale janë në gjendje të veshitë materiale). Përgatitja e raporteve mujore të numrit të fletëparaqitjeve që shkojnë në Gjykata, dhe	Janar-Dhjetor	Gjykatat	APK/MBPZHR	Kosto administrative

	numri i Vendimeve dhe lartësia e dënimeve nga Gjykatat për prerësit ilegal të pyjeve;				
21	Organizimi i Kampanjave vetëdijësuese mediale dhe shfaqëtorë për rëndësinë e parandalimit / zvogëlimit të niveilit të prerjeve ilegale, si dhe rolit të pyjeve në jetën e njeriut (konform dokumentit të strategjisë së komunikimit, të hartuar nga projekti i implementuar nga FAO);	Janar-Dhjetor	MBPZHR/APK		Organizimi i kampanjave; Kosto administrative, dhe kostoja tjetër për: Kampanja vetëdijësuese, broshura, mediale eji 50,000 € / vit
22	Krijimi i Task-Forcës për mbrojtjen e pyjeve në nivel regional në qendrat e mëdha të vendit: Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Gjilan dhe Pejë, në përbeje: Kryetarët e komunave, Kryetari i Gjykatës, Kryetari i Prokurorisë, Komandanti i Stacionit të Policë, Drejtori i Drejtorisë Koordinuese Regionale të APK-së dhe Përgjegjësit e NJK të APK-së;	Janar-Qershor	Komunat, Gjykatat Prokuroritë Policia APK	MBPZHR	Kosto administrative
23	Duke qenë së pyjet në Parkun Kombëtar "Sharrë" dhe Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", janë nën kompetencën e administrimit të Drejtorisë së Parqeve Kombëtare, në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe ku MBPZHR- APK nuk ka kompetenca në sferën e menaxhimit profesional të pyjeve, atëherë, një Plan Veprimi i veçantë për mbrojtjen e pyjeve në këto dy Parqe Kombëtare, duhet të përgatitet nga MMPHI, dhe t'i bashkëngjitet këtij Plan të Veprimit, si dhe të arrihet marrëveshje / koordinim në mes të dy ministrive për menaxhimin e pyjeve në të dy Parqet Kombëtare;	Janar-Mars	MMPHI	APK/MBPZHR	Kosto administrative

Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Faton Peçi

